

Mirë se vini në shkollën!

SKAP

dialog

Albansk



Mund t'i ndihmoni fëmijët Tuaj në të mësuarit!

A e dini që....

- qëndrimet Tuaja pozitive ndaj shkollës kanë rëndësi të madhe për kënaqësinë, nxitjen dhe mësimin e fëmijës?
- shpresat e fëmijëve, përkrahja, udhëzimet dhe reagimet ndaj punës në shkollë janë më të rëndësishëm se sa mendon shumica e njerëzve?
- ka rëndësi të madhe për fëmijët që të kenë mundësi të tregojnë se ç'kanë mësuar dhe çka janë duke punuar?
- kur i jepni ndihmë fëmijëve në kryerjen e detyrave është më e rëndësishme të pyetni se sa të përgjigjeni në çdo gjë?

Kështu mund ta ndihmoni fëmijën Tuaj!

Mund ta mësoni fëmijën Tuaj që të ketë gëzim në leximin

- duke lexuar ose duke dëgjuar libra bashkë me fëmijën
- duke treguar histori, gazmore dhe gjëza
- duke luajtur me gjuhën dhe me shkronjat

Mund të mësoni fëmijës Suaj gëzimin e llogaritjes

- duke e gjurmuar matematikën në jetën e përditshme
- duke luajtur lojëra me numra dhe me figura
- duke e pyetur fëmijën se ç'ka mësuar dhe ç'do të thuhet nocionet



Përdorni mundësinë e takimeve familje-shkollë!

A e dini që....

konferencat/bisedimet mbi zhvillimin janë takime të rëndësishme? Ato janë bisedime në mes Jush dhe mësuesit kontaktues të fëmijës Suaj. Është vendosur me ligj që gjatë çdo vitit shkollor duhet të mbahen dy mbledhje të këtilla. Në mbledhjet e prindërve takoni prindërit tjerë dhe arsimtarët. Një mbledhje e mirë e prindërve karakterizohet nga aktiviteti dhe bashkëbisedimi.

Bëni pyetje!

Në mbledhjet e prindërve mund të bëni pyetje mbi:

- Çfarë pret shkolla nga ne si prindër?
- Çfarë mund të pres unë nga shkolla?
- Ç'mund të bëj unë për të përcjellur shkollimin në familjen tonë?
- Si mund të kontribuoj për një bashkësi të mirë sociale dhe për një mjedis të mirë arsimor?

Një bashkësi e mirë e prindërve shërben për të mirën e fëmijëve. Angazhohuni në aktivitetet ku mund të njiheni më mirë me prindërit tjerë.

Bëhuni prindër kontakti!

Prindërit zgjedhin çdo vit prindër kontakti nga mesi i prindërve të fëmijëve në të njëjtën klasë/shkollë ose grup. Prindërit kontakt janë hallka që i lidh prindërit me shkollën. Prindërit kontakt bashkëpunojnë ndër tjerë me mësuesin kontaktues për të përgatitur dhe për të mabjtur mbledhjet e prindërve. Shfrytëzoni mundësinë – bëhuni prind kontakti!

Informacion i rëndësishëm!

Mësues: Emër: _____ Telefon: _____ Postë elektronike: _____

Prind kontaktues _____

Prind kontaktues _____

www.fug.no

Këshilli i prindërve për shkollën fillore (shkurtuar: FUG) është një organ këshilldhënës për Ministrinë e Arsimit. FUG ka për detyrë të kujdeset për interesin e prindërve në shkollë dhe për një bashkëpunim të mirë në mes të shkollës dhe të prindërve.

Foreldreutvalget for grunnsopplæringen

Postboks 9360 Grønland, 0135 Oslo
post@fug.no